KËRKESË
Nr.8149/1, datë 24.11.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rrëshen-Kalimash" (objekte).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim.Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Në këtë publikim është pasqyruar vetëm vlerësimi i objekteve, ndërsa sipërfaqja e tokës që preket do të publikohet në një moment të dytë, pasi të bëhen plotësimet përkatëse nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

Pronarët, për të cilët në kolonën "Shënime" në tabelën e publikuar, është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP", do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me të dhënat që do të rezultojnë në dokumentacionin e pronësisë, i cili do të paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e këtij shpronësimi është 6 109 173 (gjashtë milionë e njëqind e nëntë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë.

	Pronari		**ZK**	**Nr.pas.**	**Objekt vlera lekë**	**Shënime**
Gjok	Ndue	Gega	1190	27/7	3125158	Konfirmuar nga ZRPP
Ndrec	Ndue	Gega	1190	27/6	2984015	Konfirmuar nga ZRPP
	Totali				**6109173**	